



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivery	17-08-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMESHCK	5705	2023	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.912/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.912/2023 të datës 05.07.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] më adresë rruga [redacted] në Gjilan, kundër Vendimit me numër 02 Nr. 863 të datës 21.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje ndaj ankuesit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.912/2023 e datës 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anulohet Vendimi me numër 02 Nr. 863 i datës 21.06.2023 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit lidhur masës disiplinore vërejtje të shqiptuar ndaj ankuesit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Gjilanit më datë 21.06.2023 ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Gjilanit se ankuesi më datë 21.06.2023 nuk ka respektuar orarin e punës pasi që janë paraqitur në zyrë në orë 08:02, kështu që sipas përgjegjësisë që keni ju lutem që ndaj zyrtarit të lartcekura të shqiptoni vërejtje me shkrim për mosrespektimin e orarit të punës.

Kryetari i Komunës së Gjilanit më datë 21.06.2023, ka nxjerr Vendim me numër 02 Nr. 863, përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje për mos respektim të orarit të punës.

Ankuesi kundër këtij vendimi përmes postës më datë 03.07.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 05.07.2023 është pranuar dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.912/2023 me numër protokoli 5018/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.07.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Gjilanit. Ndërsa Këshilli më datë 12.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5018/2023 e datës 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Regjistrin e vijueshmërisë në punë i datës 21.06.2023; Vendimin me numër 02 Nr. 863 të datës 21.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Zarin e datës 03.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 12.07.2023; Akt Emërimit e datës 30.04.2019 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Financiar; Vendimin e datës 31.01.2022 për emërimin e Drejtoreshës së Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Gjilanit; Emailin e datës 06.07.2022 nga D.H për ankuesin; Emailin e datës 21.06.2023 nga D.H për A.H; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 31.12.2021 dhe 14.01.2023; Organogramin e Komunës së Gjilanit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimi me numër 02 Nr. 863 i datës 21.06.2023 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit lidhur masës disiplinore vërejtje, pretendon se në këtë provës ka pasur shkelje të

dispozitive të procedurës së Ligjit për Zyrtarët Publik dhe vërtetim dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji Këshillit ka analizuar provat materiale konstaton se Komuna e Gjilanit përmes përgjigjes në ankesë të datës 12.07.2023 ka theksuar se mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankuesit është Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Gjilanit mirëpo meqenëse e njëjta është e emëruar politike nuk ka ë drejtë të shqiptoj masën disiplinore kështu që masa e shqiptuar është propozuar nga ajo.

Kolegji i Këshillit, nisur nga baza ligjore e përcaktua me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se kompetenca për procedura disiplinore është e paraparë me nenin 48, si rrjedhojë paragrafi 2 i nenit 48 të këtij ligji, ka përcaktuar se: *"2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, thekson faktin dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i kanë dhënë kompetencë mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil që në rastet kur vlerësohet se nëpunësi civil ka bërë shkelej disiplinore, të ndërmarr veprimet çoftë për shqiptimin e masës së lehtë disiplinore apo inicimit të procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor për shkelje të rënda disiplinore, si rrjedhojë ky ligj me asnjë dispozitë nuk ka përcaktuar nga mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil duhet të ketë pozitë të nëpunësit civil, ngase e drejta për shqiptimin e masës disiplinore *"Vërejtje"* i është atribuuar vetëm mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil, si rezultat i kësaj nuk qëndron arsyetimi se meqenëse Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Gjilanit është e emëruar politike nuk ka të drejtë të shqiptoj masa disiplinore.

Nga provat e lëndës, konkretisht përshkrimi i detyrave të punës së pozitës së ankuesit *"Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2"* sipas Akt Emërimit të datës 30.04.20219, Kolegji i Këshillit konstaton se kjo pozitë i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Gjilanit, kjo është konfirmuar edhe nga Udhëheqësi i Njësisë për Personel i Komunës së Gjilanit përmes përgjigjes në ankesë të datës 12.07.2023.

Ndërsa në kuptim të kompetencës për inicimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *"1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: *"1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"*, rrjedhimisht sipas provave të lëndës dhe referuar kuadrit të lartcekur ligjor, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës së Gjilanit nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit dhe mbi këtë bazë nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore *"Vërejtje"*.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet si më lartë, thekson faktin se Vendimi me numër 02 Nr. 863 i datës 21.06.2023 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit lidhur masës disiplinore vërejtje të shqiptuar ndaj ankuesit, është i paligjshëm në kuptim të dispozitave nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ndërlidhur me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që për shkak të këtyre shkeljeve Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nuk u lëshua në konstatimet lidhur me shkeljet e supozuara nga ana e ankuesit.

Si u tha më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit janë të obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.912/2023, datë 17/08/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit.
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.